



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË KORÇË, TË DEPOZITUARA NGA PARTIA "BINDJA DEMOKRATIKE" PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 17.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për kthim për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë, të paraqitura nga Partia "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa a, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia "Bindja Demokratike", si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia "Bindja Demokratike", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.



Nr.512 i Vendimit

Data 17.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të Partisë "Bindja Demokratike", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Partia "Bindja Demokratike" ka paraqitur në KQZ dokumentacionin për miratimin e listave shumemërore.

Në mbledhjen e datës 17.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak të Partisë "Bindja Demokratike" dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi mangësitë e dokumentacionit si më poshtë:

1. Numri i kandidatëve është më i vogël se gjysma e numrit të mandateve në këshillin bashkiak nga 41 ka depozituar 24;
2. Deklarimi për vendet sipas kuotës gjinore Modeli 09 K;
3. Lista për plotësimin e të dhënave për kandidatët për kryetar bashkie/anëtar këshilli në listat shumemërore të partive politike, Model 13 K;
4. Formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit të bashkisë;
5. Dokumenti identifikimit dhe deklaratat e kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak.

Në këto kushte KQZ duhet:

Të kthej për plotësim dokumentacionin e kandidimit, për korrigjimin e mangësive të konstatuara, nga Partia "Bindja Demokratike".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 67, pikat 1, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për anëtarë Këshilli të Bashkisë Korçë, të Partisë "Bindja Demokratike", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr.512 i Vendimit

Data 17.05.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për kthimin për plotësim të listës shumemërore të Partisë "Bindja Demokratike", zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019